

VENDIM
Nr. 39, datë 24.11.2016

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “NEW CRED”

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pikat 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “New Cred”,

VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “New Cred” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datat 6–8 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët në shoqërinë e kursim-kreditit “New Cred”, u konstatua se:

a) në skedarët për raportim pranë Agjencisë kishte mungesa të fushave thelbësore dhe të fushave të detyrueshme për identifikimin e depozituesve, interesi ditor nuk përfshihej në balancën e agreguar, si dhe nuk kryhej konvertimi automatik i balancave në valutë.

b) nga 5027 depozitues që rezultuan në datë 5 korrik 2016, 1562 prej tyre nuk kishin dokument identifikimi, 640 nuk kishin numër personal, 900 depozituesve iu mungonte adresa, si dhe 1121 depozituesve iu mungonte numri i telefonit.

c) rreth 4000 depozitues kishin mungesa të theksuara në të dhënat identifikuese. Depozitat e këtyre depozituesve ishin klasifikuar si “depozita inaktive” dhe nuk janë raportuar në Agjenci në raportimet e mëparshme me kërkesë të Agjencisë.

ç) moduli i primit nuk e kryente saktë llogaritjen e tij;

d) paralelisht me strukturat drejtuese të SHKK-së “New Cred” funksiononin edhe strukturat drejtuese të degëve të saj;

dh) depozitat nuk kontabilizoheshin në të njëjtën mënyrë.

4. Në vijim të verifikimit të datave 6–8 korrik 2016, shoqërisë së kursim-kreditit “New Cred” iu rekomandua të merrte masa për plotësimin e mangësive, për të cilat u lanë afate të ndryshme duke filluar nga muaji shtator 2016 e deri në fund të vitit 2016.

5. Nga verifikimi përfundimtar i datës 20 tetor 2016 mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna, grupi i verifikimit të Agjencisë konstatoi se:

a) sistemi elektronik mundësonte gjenerimin e skedarëve për raportim pranë Agjencisë, por plotësimi i fushave dhe formatimi i tyre nuk ishte në përputhje me formatin standard të skedarëve;

b) sistemi elektronik mundëson llogaritjen e primit, por moduli i llogaritjes së primit ende gjeneron pasaktësi;

c) nuk u mundësua gatishmëria e sistemit dhe për këtë arsye ishte e pamundur një kontroll i mirëfilltë i cilësisë së të dhënave;

ç) depozituesit me probleme në cilësinë e të dhënave ishin kontabilizuar si “detyrime të tjera”. Me vendim datë 25 shtator 2016, të Këshillit Drejtues të SHKK-së “New Cred”, ishin përjashtuar nga anëtarësia mbi 4000 depozitues. Ky vendim nuk kishte të bashkëlidhur një listë emërore të këtyre depozituesve. Vlera e depozitave sipas listës që iu vu në dispozicion grupit të verifikimit, nuk përputhej me lëvizjet kontabël në zërat përkatës të bilancit të raportuar;

d) numri i degëve të raportuara pranë Agjencisë nuk përputhej duke variuar nga 12–19 degë;

ë) për përmbushjen e disa prej rekomandimeve të tjera të shprehura në raportin e verifikimit, shoqëria e kursim-kreditit “New Cred” ishte ende në pritje të një versioni të ri të sistemit elektronik, i cili më datë 20 tetor 2016 nuk kishte përfunduar ende.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “New Cred” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “New Cred”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “New Cred” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR
Donald Duraj